



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS TABLE TENNIS FEDERATION OF KOSOVO

Bazuar në nenin 7 të Rregullores për reprezentacionet e pingpongut të Kosovës e në pajtim me nenin 27 të Statutit të Federatës së Pingpongut të Kosovës Bordi i FPPK-së në mbledhjen e datës 10.02.2023 nxori Vendim që të publikoi këtë:

KONKURS

Për postin e Drejtorin e Përfaqësueses së Kosovës në pingpong

KUSHTET

Një person për t'u emëruar Drejtor i Perfaqesueses duhet të plotësoj këto kushte:

1. të jetë veprimtar i dalluar i sportit të pingpongut me rezultate kulminante në organizimin dhe udhëheqjen e sportit;
2. të ketë përgatitje superiore shkollore, preferohet fakulteti i edukatës fizike, ose i certifikuar në njërin nga nivelet formale të ITTF për trajner;
3. të njej një gjuhë botërore, përparësi i jepet gjuhës angleze;
4. mos të ketë rënë në kundërshtim me normat etike dhe morale dhe me parimet e Lëvizjes dhe Kartës Olimpikë dhe të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale.

Përshkrimi i detyrave të Drejtorit të Përfaqësueses, përpilon:

- Propozimin e programit njëvjeçar dhe katërvjeçar të punës së reprezentacionit,
- Propozimin e planit të përgatitjeve të reprezentacionit,
- Propozimin e kalendarit të garave të reprezentacionit për sezonin e ardhshëm, duke marrë parasysh që garat lokale të jenë në funksion të paraqitjes sa më të suksesshme të reprezentacionit në gara ndërkombëtare,
- Propozimin e obligimeve të kandidatëve për reprezentacion për vitin e ardhshëm.

MANDATI

- 4 vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat
- kontrata do të bazohet në pagese fikse ditore dhe bonuse në baze të performances

AFATI I PARAQITJES

Afati i aplikimit është nga data **11.02.2023 deri me 28.02.2023.**

Aplikacioni i kompletuar duhet të përmbajë

- Cv
- Diploma universitare ose Certifikata për kryerjen e Nivelit I apo II për trajner ndërkombtar
- Dëshmi për punën aktive si trajner, përfshirë numrin e sportistëve sipas grupmoshave
- Dëshmi për rezultate e arritura individuale dhe ekipore si në gara individuale dhe ekipore në arenën vendore dhe ndërkombëtare
- Dëshmi nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë.
- Certifikatë për njohjen e gjuhës angleze
- Një përmbledhje të programit të punës 1 dhe 4 vjeçare për punën me përfaqësuesen dhe ngritjen e cilësisë

Dokumentacioni i kompletuar duhet të të dërgohen në email adresën: **sg@fppk.com** ose të shtypura në Zyren e FPPK-se..

Shtëpia e Sporteve, rr. Agim Ramadani Nr 43, zyra nr 7, Prishtinë
Tel +383 44 170 586, e-mail: sg@fppk.com, web www.fppk.com